



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 143/6 prot.

Tiranë, më 23.3.2023

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 621, datë 13.2.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Erarbër Madhi
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dajeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 9.3.2023 është njoftuar vendimi nr. 621, datë 13.2.2023, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit, z. Erarbër Madhi, gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

Ndaj këtij vendimi, bazuar në nenin B, pika 3, germa “c”, të aneksit të Kushtetutës, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 9.3.2023, është depozituar akti: “Rekomandim për paraqitje ankimi”¹, nënshkruar nga një komision prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor, nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, Komisioneri Publik, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, datë 9.3.2023, ushtron ankim ndaj vendimit nr. 621, datë 13.2.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

¹ Akti nr. 145/1 prot., datë 9.3.2023.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Erarbër Madhi, ushtron detyrën e gjyqtarit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë dhe, në zbatim të pikës 3 të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1² e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Erarbër Madhi, ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kriterëve, atë të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni), ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si *ILDKPKI*), raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si *DSIK*) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim referuar si *KLJG*), nga të cilat rezulton se:

2.1 **ILDKPKI**, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë së subjektit Erarbër Madhi,”³ ka referuar se:

- i. Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ii. Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- iii. Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv. Nuk ka kryer deklaram të rremë;
- v. Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 **DSIK**, bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Erarbër *** Madhi⁴, ka referuar “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Erarbër *** Madhi”.

2.3 **KLJG**, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, ka përcjellë pranë Komisionit Raportin⁵ për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Erarbër Madhi.

3. Përfundimet e Komisionit, për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

3.1 **Për vlerësimin e pasurisë.** Referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, hetimi administrativ i Komisionit është shtrirë në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve, ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, ligjshmërinë e të ardhurave, shpenzimet etj., për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të. Komisioni, pasi ka analizuar dhe vlerësuar provat dhe faktet e dala nga hetimi administrativ,

² Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, DH dhe E të këtij aneksi dhe ligjit.

³ Shkresa e ILDKPKI-së me nr. ***/***/***/ prot., datë ***.8.2018.

⁴ Shkresa e DSIK-së nr. *** prot., datë ***.11.2017, e deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr. ***, datë ***.2.2022.

⁵ Raport i KLJG-së nr. ***/***/***/ prot., datë ***.11.2021.

provat dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e barrës së provës, ka arritur në përfundimin se: [...] *subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht, si dhe ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht në Deklaratën “Vetting” pasuritë e tij dhe të personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës.*

Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij. Nga hetimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim ose në përdorim të tij. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit Erarbër Madhi nuk vërtetohen shkaqet që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatohej parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

Komisioni vlerëson të ndalet edhe në mungesën e burimeve financiare prej 313.323 lekësh. Referuar jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit⁶, kjo mungesë burimesh financiare nuk mund të konsiderohet si deklaram i pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 [...] ⁷. Në këto kushte, Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit, z. Erarbër Madhi, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

3.2 Për kontrollin e figurës. Referuar nenit DH të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në konsideratë të verifikimit dhe të konfirmimit nga institucionet përgjegjëse për përshtatshmërinë e subjektit, edhe pas hetimit administrativ, ka arritur në përfundimin se: [...] *Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, edhe pas përditësimit të informacionit nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të aneksit të Kushtetutës [...] ⁸. Në këto kushte, Komisioni, në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Erarbër Madhi, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.*

3.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale. Referuar nenit E të aneksit të Kushtetutës, nenit 43/2 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016, si dhe kreut II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, të ndryshuar, Komisioni, pasi ka administruar raportin e përgatitur nga KLGJ, denoncimet e depozituara në Komision dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, ka arritur në përfundimin se: [...] *Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga KLGJ-ja, denoncimeve të depozituara në Komision dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si më sipër, trupi gjykues vëren se nuk mund të ngrihen dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e gjyqtarit.*

Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe konsiderohet “i aftë” në aspektin profesional [...] ⁹. Për sa më sipër, Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Erarbër Madhi, ka arritur një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

⁶ Vendimet nr. 24/2021, nr. 38/2021, nr. 17/2022 dhe nr. 27/2022.

⁷ Referohuni arsyetimit të Komisionit, në faqen 30 të vendimit.

⁸ Referohuni arsyetimit të Komisionit, në faqen 31 të vendimit.

⁹ Referohuni arsyetimit të Komisionit, në faqen 67 të vendimit.

4. Vendimi i Komisionit. Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, Komisioni, me vendimin nr. 621, datë 13.2.2023, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, sipas parashikimit të nenit 55, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, bazuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, germa “a”, dhe nenin 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, me shumicë votash,¹⁰ ka vendosur: “1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Erarbër Madhi, gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë”.

II. Rekomandimi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)

5. Bazuar në nenin B, pika 3, germa “c”¹¹ e aneksit të Kushtetutës, një komision i përbërë nga tre përfaqësues të ONM-së, më datë 9.3.2023, kanë paraqitur pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë: “Rekomandim për paraqitje ankimi” ndaj vendimit nr. 621, datë 13.2.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, z. Erarbër Madhi (bashkëlidhur këtij ankimi).

6. Në mënyrë të përmbledhur, çështjet e ngritura nga ONM në rastin e subjektit të rivlerësimit, z. Erarbër Madhi, lidhen me pasuritë e trashëguara më datë ***.5.2019, nga nëna e tij, **e ndjera** (znj. *** ***), konkretisht: (i) Apartament me sip.124,7 m², i ndodhur në Tiranë, rruga “*** ***”, Njësia Administrative nr. **, pallati nr. **, hyrja ***, blerë nga nëna e subjektit të rivlerësimit, znj. *** ***, në vlerën 16.776.450 lekë; (ii) llogari bankare në shumën 4.490.000 lekë, të ardhura nga maturimi i bonove të thesarit, të cilat nëna e subjektit të rivlerësimit i ka investuar/blerë në datën ***.1.2009, në vlerën 4.000.000 lekë.

6.1 Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, ka arritur në konkluzionin paraprak se pasuritë e mësipërme nuk mund ta kishin origjinën nga të ardhurat e prindërve të ndjerë të subjektit të rivlerësimit (siç ai ka deklaruar), por nga burime të padeklaruara të subjektit të rivlerësimit. Rrethanat faktike, të konstatuara gjatë hetimit administrativ, krijojnë bindjen se pasuritë *bono thesari* dhe *apartament banimi me sipërfaqe 124,7 m²*, ndodhur në Tiranë, rruga “*** ***”, blerë nga znj. ***, përkatësisht në vitin 2009 dhe 2012, janë në realitet pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit, ndaj dhe i kaloi këtij të fundit barrën e provës bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

6.2 ONM vlerëson se dosja e çështjes përmban prova objektive dhe të qëndrueshme të natyrës rrethanore, që ka qenë subjekti i rivlerësimit që ka siguruar burimin e krijimit të pasurive dhe se ai nuk ishte në gjendje të rrëzonte barrën e provës.

6.3 Pretendimet kontradiktore të subjektit të rivlerësimit mbetën të pabesueshme dhe të paprovuara. Çështjet, si në aspektin e mangësive në deklarime dhe në aspektin e analizës financiare, dhe pasojat e tyre të mundshme për subjektin e rivlerësimit, janë të një rëndësie të tillë, që kërkojnë rishikim nga ana e Kolegjit.

6.4 Për sa me sipër, ONM rekomandon që Komisioneri Publik të ankimojë vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit të datës 13.2.2023, për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Erarbër Madhi.

¹⁰ Znj. *** ***, relatores e trupit gjykues ka votuar “kundër”, duke dalë me mendim në pakicë.

¹¹ Vëzhguesi ndërkombëtar ushtron këto detyra ... u jep Komisionerëve Publikë rekomandime me shkrim për të paraqitur ankim. Në rast se Komisioneri Publik nuk i zbaton rekomandimet, ai përgatit një raport me shkrim, duke dhënë arsyet e refuzimit.

III. Vlerësimi i Komisionerit Publik

7. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).
8. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisionerit Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit kontrollues/rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).
9. Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.
10. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave të administruara.
11. Edhe në rastin konkret, Komisioneri Publik, pasi shqyrtoi dhe vlerësoi vendimin nr. 621/2023 dhe aktet shoqëruese të tij, bazuar edhe në Rekomandimin e ONM-së, datë 9.3.2023, çmon se vendimi është i cenueshëm në tërësinë e tij dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.
12. Në përfundim të sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 2 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe nenet 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik ushtron të drejtën e ankimit ndaj vendimit nr. 621/2023 të Komisionit.

IV. Analiza e shkaqeve të ankimit

IV.A. Kontrolli i pasurisë

13. Në lidhje me vlerësimin e kriterit të pasurisë, referuar nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 - 33, të ligjit nr. 84/2016, si dhe jurisprudencës së Kolegjit, Komisioneri Publik mban në konsideratë se gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi sipas nenit 179/b, të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit ("Vetting" dhe ato periodike). Në çdo rast, subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, si dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues.
14. Rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Erarbër Madhi, ka deklaruar për herë të parë në vitin 2004 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", të

ndryshuar, dhe ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, ka dorëzuar në ILDKPKI deklaratat e interesave privatë periodikë për vitet 2004 - 2016 (në vijim DV - 20--). Në datën ***.1.2017 ka dorëzuar në ILDKPKI Deklaratën “Vetting”, sipas shtojcës nr. 2 të ligjit nr. 84/2016.

15. Në Deklaratën “Vetting”, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pasuri të paluajtshme në posedim apo përdorim, ndërkohë në përgjigjet e pyetësorit standard të Komisionit, subjekti ka deklaruar se gjatë periudhës qershor 2019 e në vijim ka banuar në adresën Njësia Administrative nr. **, rruga “**** **”, Nd. **, H. ***, Ap. ***, ***, Tiranë.

16. Nga korrespondenca e Komisionit me institucionet shtetërore e ato private ka rezultuar se: (i) ASHK, me shkresën nr. ***/** prot., datë **.10.2020, e më tej me shkresën nr. ***/** prot., datë ***.2.2022, ka informuar Komisionin se në emër të subjektit të rivlerësimit rezulton e regjistruar pasuria me nr. **/***+**_*** vol. ***, f. ***, ndodhur në z. k.***, duke vënë në dispozicion praktikën përkatëse të origjinës së saj; (ii) Banka e Shqipërisë, me shkresën nr. ***/*** prot., datë **.9.2020, ka konfirmuar se në emër të nënës së subjektit të rivlerësimit, znj. *** ***, rezulton të jetë hapur llogari *cash*/titujsh për blerjen e bonove të thesarit të shtetit shqiptar.

17. Nga verifikimi i akteve bashkëlidhur praktikës së ASHK-së ka rezultuar kontratë shitblerje me nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.4.2012, nënshkruar midis palëve *** e *** ***, në cilësinë e shitësve, dhe znj. ***, nëna e subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e blerëses, me objekt shitjen e pasurisë apartament me sipërfaqe 124,27 m², ndodhur në Tiranë, pasuri me nr. **/***+**_***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, në vlerën 16.776.450 lekë, çmim i cili sipas kontratës është likuiduar në zyrën noteriale nga ana e blerëses, në favor të shitësve në ditën e nënshkrimit të kontratës¹².

17.1 Referuar aktit Certifikatë për vërtetim pronësie me nr. ***¹³, pasuria është regjistruar në favor të blerëses, znj. ***, në datën ***.4.2012.

18. Nga verifikimi i akteve bashkëlidhur praktikës së Bankës së Shqipërisë ka rezultuar se investimi fillestar në tituj bono thesari është në vlerën 4.000.000 lekë, në datën **.1.2009,¹⁴ në emër të znj. ***, e më tej kjo shumë është riinvestuar, duke arritur në vlerën 4.490.961 lekë, datë **.1.2020.

19. Nga aktet në dosje të Komisionit rezulton se në datën ***.5.2019, me “Vendim dëshmi trashëgimi ligjore”, nr. *** rep., nr. *** kol., subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e trashëgimtarit të vetëm të znj. ***, ka trashëguar gjithë pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të trashëgimlënës.

19.1 Pasuria *apartament banimi me sipërfaqe 124,27 m²* është regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit në datën **.7.2019, sipas kartelës së pasurisë së paluajtshme, ndërsa shuma prej 4.490.861 lekë është transferuar nga llogaria e znj. *** në llogari në emër të subjektit të rivlerësimit në datën **.1.2020, pranë Bankës *** ***.

¹² Pasuria rezulton se është blerë nga shitësi në vlerën 1.900.000 lekë në vitin 2000 dhe është rivlerësuar nga këta të fundit në datë **.4.2012 në vlerën 16.776.450 lekë.

¹³ Dërguar nga A.SH.K, Drejtoria Vendore Tiranë Jug me shkresën ***/** prot., datë **.10.2020.

¹⁴ Datë ***.12.2009 është rivendosur Bono thesari në vlerën 4.500.000 lekë.

20. Komisioni, pasi ka vlerësuar se znj. *** ka qenë person i lidhur me subjektin e rivlerësimit deri në datën **.4.2012, i ka kërkuar të fundit dokumentacion mbi *mënyrën e krijimit të kësaj pasurie nga nëna e tij, burimin e krijimit të kësaj pasurie, si dhe investimin e kryer për arredim dhe mobilim të apartamentit. Nëse nëna e subjektit të rivlerësimit ka pasur pasuri të tjera dhe cilat kanë qenë të ardhurat e saj dhe puna që kryente*¹⁵.

21. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e tij, datë 24.1.2022, ka pretenduar se nëna e tij nuk duhet të konsiderohet person i lidhur apo tjetër i lidhur me të, pasi midis tij dhe nënës së tij nuk ekziston asnjë interes pasuror apo çdo marrëdhënie biznesi në kuptim të ligjit nr. 84/2016.

21.1 Lidhur me burimin e krijimit të pasurive të znj. ***, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se pasuria në fjalë e llojit *apartament me sipërfaqe 124,27 m²* është blerë me kursimet e gjithë jetës të prindërve të tij (babai pas vdekjes, të gjitha kursimet e krijuara gjatë gjithë jetesës së tyre të përbashkët ia ka lënë nënës).

22. Komisioni, nëpërmjet pyetësorit të datës 24.1.2022, ka pyetur gjithashtu subjektin e rivlerësimit lidhur me burimin e shumës së investuar nga znj. *** në bono thesari, në vlerën 4.000.000 lekë, në vitin 2009, për të cilën subjekti ka deklaruar se pasuria në fjalë e llojit *likuiditet*, është pjesë e pasurisë personale të prindit, krijuar me kursimet e gjithë jetës së babait dhe nënës (babai pas vdekjes, të gjitha kursimet e krijuara gjatë gjithë jetesës së tyre të përbashkët ia la nënës).

23. Më tej, në përgjigje të pyetësorit të datës 19.4.2022, subjekti ka deklaruar të ardhura nga punësimi i të atit *për shkak të punës në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, nga aktivitete të tjera brenda vendit dhe në institucione ndërkombëtare, si dhe nga dietat në kuadër të aktivitetit si ekspert pranë organizatave ndërkombëtare dhe udhëtimeve jashtë shtetit, në këtë kuadër apo në kuadër të trajnimeve përkatëse*, në vlerën rreth 2,6 milionë lekë dhe 511.000 USD. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se kursimet nga këto të ardhura, në shumën rreth 350.000 USD, janë mbajtur në banesë dhe pas vdekjes së të atit, në vitin 2005, i kanë mbetur nënës së tij.

24. Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit vetëm kopje të pasaportës së të atit, fotografi nga eventet në të cilat ka marrë pjesë, si dhe disa certifikata pjesëmarrje dhe falënderimi.

25. Komisionit, nga aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe ato të administruara nga korrespondenca me institucionet përgjegjëse, i ka rezultuar se i ati i subjektit ka përfituar të ardhura neto në shumën 1.898.399 lekë¹⁶. Në përfundim, me rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit barrën e provës, pasi:

25.1 *Për pasurinë apartament me sipërfaqe 124,27 m², mbështetur në praktikën e Kolegjit dhe në parashikimet e nenit D, pika 1,3 dhe 5, të aneksit të Kushtetutës, Komisioni në rastin objekt shqyrtimi, në kuadër të një vendimmarrje sa më të drejtë, pas analizimit të provave të*

¹⁵ Referohuni *email*-it të Komisionit drejtuar subjektit në datën 20.1.2022.

¹⁶ Komisioni është mbështetur në shkresën nr. ***/** prot., datë ***.9.2022, të *** Bank, shkresën nr. ***/** prot., datë ***.9.2022, të Arkivit ISSH Lundër dhe shkresën nr. ***/** prot., datë **.10.2022, të Ministrisë së Mbrojtjes.

mblledhura gjatë hetimit dhe në analizë të shkaqeve të rrethanave të rezultuara, ka vlerësuar të kualifikojë këtë pasuri si pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit¹⁷.

25.2 *Për pasurinë likuiditete të investuara në bono thesari, duket se znj.*** është në pamjaftueshmëri financiare për investimin fillestar në shumën 4.000.000 lekë, në vitin 2009. Ngrihen dyshime se kjo pasuri monetare është pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit, e krijuar gjatë kohës së ushtrimit të detyrës.*

26. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ka ritheksuar të njëjtat argumente të përdorura në përgjigje të pyetësorëve të Komisionit, mungesën e detyrimit për të provuar burimet e nënës së tij, e cila nuk duhet të konsiderohet person tjetër i lidhur në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe mungesën e dënjësive për krijimet e këtyre pasurive, duke ritheksuar se pasuritë e mësipërme kanë si burim kursimet e gjithë jetës së prindërve të tij, duke listuar të njëjtat marrëdhënie punësimi të të atit, por përsëri pa vënë në dispozicion akte mbi të ardhurat e pretenduara.

27. Komisioni (shumica), në përfundim ka vlerësuar se: [...] *në këto kushte, Komisioni arriti në përfundimin se, për shkak të fakteve dhe rrethanave specifike si më sipër trajtuar, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit konsiderohen të besueshme dhe bindëse, për sa kohë, në mungesë të provës së kundërt, e gjithë dinamika e veprimeve të kryera nga nëna e tij në lidhje me këto pasuri e shkëput subjektin e rivlerësimit nga marrëdhënia direkte e pronësisë me këto sende për të gjithë kohën e krijimit të këtyre pasurive e derisa nëna e tij ka qenë gjallë. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se, përpos dyshimeve të ngritura përgjatë hetimit administrativ, nuk u verifikuan apo provuan fakte dhe/ose rrethana që mund të çonin përtej çdo dyshimi të arsyeshëm në një konkluzion të bazuar për fshehjen e këtyre pasurive nga ana e subjektit, që mund ta vendosnin këtë të fundit në kushtet e parashikuara nga neni D, pika 5 e aneksit të Kushtetutës. Në përfundim, Komisioni çmon se, duke mos u kristalizuar një pamjaftueshmëri e qartë mjetesh financiare për nënën e subjektit, lidhur me krijimin e pasurive në analizë dhe në mungesë të provës së dhënies të ndonjë kontributi financiar nga ky i fundit, parë nën dritën e parimit të proporcionalitetit, si dhe duke mbajtur në konsideratë vështirësitë dhe pamundësitë e konstatuara përgjatë hetimit administrativ, për të hedhur dritë mbi saktësimin sasior të kursimeve të mundshme të realizueshme nga prindërit e subjektit, në dekadat pararendëse nuk mund të mjaftojë vetëm fakti i përfitimit final të këtyre sendeve, për më tepër nëpërmjet aktit të trashëgimisë ligjore për të penalizuar subjektin e rivlerësimit. [...]*¹⁸.

28. **Komisioneri Publik**, për sa më sipër, bazuar edhe në aktin “*Rekomandim për paraqitje ankimi*”, nr. 145/1 prot., datë 9.3.2023, nënshkruar prej tre vëzhguesve ndërkombëtarë, ndan vlerësim të ndryshëm nga Komisioni, për sa do të trajtohet në vijim:

29. Për pasuritë si më sipër, *bono thesari me vlerë 4.000.000 lekë dhe apartament banimi me sipërfaqe 124,27 m² me çmim blerje 16.776.450 lekë, pasuri në vlerë totale prej 20.776.450 lekë, nisur nga rrethanat faktike të konstatuara gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin për të provuar burimin e ligjshëm të krijimit të tyre, pasi rezultojnë këto rrethana objektive:*

¹⁷ Referohuni rezultateve të hetimit administrativ, f. 12-13.

¹⁸ Referohuni arsytimit të Komisionit, në f. 24-28 të vendimit të arsyetuar.

29.1 Investimi i znj. *** në pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, rezulton në vlerë të konsiderueshme.

29.2 Investimi në bono thesari është kryer në vitin 2009 dhe investimi në pasurinë apartament me sipërfaqe 124,27 m², është kryer në vitin 2012, për të cilat si burim krijimi pretendohet se janë kursimet nga të ardhurat e përfituara nga puna e të atit, i cili ka ndërruar jetë në vitin 2005.

29.3 Subjekti ka qenë në të njëjtën certifikatë familjare me nënën e tij, për periudhën minimalisht prej datës ***.5.2005 – ***.4.2012¹⁹, dhe është larguar nga përbërja familjare vetëm katër ditë pas kryerjes së transaksionit të blerjes së apartamentit nga nëna e tij, rrjedhimisht të dyja pasuritë në analizë rezultojnë të krijuara nga nëna e subjektit gjatë kohës që ky i fundit ka qenë në të njëjtën përbërje familjare me të dhe në funksionin gjyqtar²⁰.

29.4 Nëna e subjektit, znj. ***, nuk mund të ketë gjeneruar të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar investimin e këtyre pasurive, bazuar në aktet e administruara gjatë hetimit administrativ.

29.5 Subjekti ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit mbi konsiderimin e znj. *** si person të lidhur sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016. Bazuar në deklaratimet e subjektit në pyetësorin e datës 19.4.2022, se këto pasuri janë krijuar me kursime nga të ardhurat e realizuara nga babai i subjektit, trashëguar nga e ëma pas vdekjes së tij në vitin 2005, nga verifikimi i akteve në dosje, sikundër dhe Komisioni ka konstatuar, rezulton se të ardhurat e ligjshme të realizuara nga punësimi i të atit, provuar me dokumentacion, janë në vlerën 1.898.399 lekë, të cilat nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar investimet e nënës së subjektit në vitet 2009 dhe 2012, llogaritur në vlerën totale 20.776.450 lekë.

29.6 Pretendimet e subjektit mbi të ardhurat e përfituara nga i ati nga institucionet ndërkombëtare, në vlerën totale prej rreth 511.000 USD, mbetën në nivel deklarativ dhe të paprovuara. Të ardhurat e pretenduara nuk u provuan as nga hetimi administrativ i Komisionit, ndërkohë Ministria e Mbrojtjes ka konfirmuar se nuk i ka paguar të atit të subjektit pagesa shtesë për pjesëmarrjen në misione. Pretendimi i subjektit mbi të ardhurat e përfituara nga i ati në formë dietash, përveçse i paprovuar, është dhe në kundërshtim me jurisprudencën e Kolegjit, mbi trajtimin e të ardhurave në formën e dietës.

29.7 Gjatë hetimit nuk rezultuan gjurmë, akte konfirmimi apo lëvizje të llogarive bankare, si për të ardhurat e pretenduara të përfituara, ashtu dhe për kursimet e pretenduara se janë trashëguar nga nëna e subjektit pas vdekjes së babait të subjektit.

29.8 Deklarimet e subjektit mbi vendqëndrimin e tij gjatë periudhës 2004-2019 janë kontradiktore. Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën **.8.2014, subjekti ka deklaruar se *jeton në shtëpinë e mamasë, në adresën e dhënë në deklaratimet periodike, rruga "**** **", Tiranë, e cila jeton me qira dhe pagesa e qirasë, në shumën 25.000 lekë/muaj, paguhet nga ajo*. Në pyetësorin standard, subjekti i rivlerësimi, për periudhën shtator 2004 - qershor 2019, ka deklaruar si adresë banimi: "Njësia Bashkiake nr. **, rruga "**** **", pallati **/**, shk./**, K. **, Ap./**", në apartamentin e marrë me qira prej

¹⁹ Referohuni shkresës së Gjendjes Civile nr. ***/** prot., datë ***.6.2022.

²⁰ Në Gjykatën e Rrethit Fier, deri në tetor 2005 dhe Rrethit Vlorë, deri në vitin 2013.

tij.²¹ Ndërkohë, gjatë seancës dëgjimore, avokati i subjektit ka deklaruar se: *deklarimi në ILDKPKI në vitin 2014 përmban një lapsus, në apartamentin me adresë në rrugën “*** **” ka banuar vetë subjekti, pasi e ëma, që nga muaji shtator 2005 (moment i shitjes së pasurisë në pronësi të subjektit dhe së ëmës në rrugën “*** **”, Tiranë²²) e në vijim, ka vijuar të banojë në pasurinë e trashëguar nga prindërit e saj, në rrugën “** **”, Tiranë. Duke filluar nga data ***.4.2012, ajo ka fituar pronësinë në apartamentit 124.27 m², Tiranë.*

29.9 Nga verifikimi i deklaratave periodike, dorëzuar në ILDKPKI, rezulton se në DV 2005 - DV 2016²³ e në Deklaratën “Vetting”, subjekti ka deklaruar si adresë banimi: rruga “*** **”. Nëna e subjektit të rivlerësimit, bazuar në shkresën nr. ***/**, datë **.9.2020, të Bankës së Shqipërisë, ka deklaruar si adresë banimi: rruga “*** **”. Nga aktet në dosje duket se subjekti i rivlerësimit dhe nëna e tij kanë banuar në të njëjtën adresë, edhe pas shkëputjes nga certifikata familjare në datën ***.4.2012.

29.10 Deklarime kontradiktore të subjektit rezultojnë dhe lidhur me vendqëndrimin e tij gjatë periudhës 2004-2013, pasi në *procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI datë **.8.2014, subjekti ka deklaruar se gjatë kësaj periudhe, për shkak të marrëdhënies së punës, e ka kryer vajtje-ardhje çdo ditë dhe në disa raste ka jetuar tek të njohurit pa pagesë, ndërkohë gjatë hetimit administrativ dhe në seancën dëgjimore, subjekti ka deklaruar se gjatë kësaj periudhe ka jetuar në apartamentin e marrë me qira në Vlorë.*

29.11 Referuar shkresës nr. ***/** prot., datë **.9.2020, të Furnizuesit të Shërbimit Universal, rezulton se për kontratën e furnizimit me energji elektrike të znj. ***, për periudhën maj 2012- maj 2019, nuk ka konsum energjie dhe është paguar vetëm tarifa bazë (340-658 lekë/muaj).

29.12 Gjatë seancës dëgjimore, në përgjigje të pyetjeve drejtuar nga vëzhguesi ndërkombëtar, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se i ati, duke punuar për organizata ndërkombëtare, të cilat sistemin e taksave e kanë të rregulluar me akte te veçanta, dhe rrjedhimisht të ardhurat e realizuara nuk i nënshtroheshin legjislacionit tatimor shqiptar, pretendim i cili nuk gjen mbështetje, pasi për periudhën në fjalë ka rezultuar se babai i subjektit, ***, **, nuk ishte pjese e stafit të NATO-s. Bazuar në përgjigjen e Ministrisë së Mbrojtjes, me shkresën nr. ***/** prot., datë **.10.2022, babai i subjektit ka qenë ushtarak aktiv deri në vitin 2002, pra pjesë e strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura të shtetit shqiptar.

30. Komisioneri Publik, referuar situatës faktike të përshkruar më sipër, deklarimeve të subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, si dhe bazuar edhe në aktin “*Rekomandim për paraqitje ankimi*”, të datës 9.3.2023, vlerëson se rrethanat faktike janë të tilla që të krijojnë bindjen se nëna e subjektit të rivlerësimit nuk kishte burime financiare, të mundshme apo të disponuara, për krijimin pasurive si më sipër, në vlerën 20.776.450 lekë.

30.1 Të ardhurat e pretenduara nga babai i subjektit të rivlerësimit, përveçse mbetën të paprovuara, duken dhe jo të besueshme, si dhe i përkasin një periudhe kohe të largët (1993-2005, referuar pretendimeve të subjektit), nga momenti i krijimit të pasurive (2009 dhe

²¹ Gjatë periudhës shtator 2007- korrik 2013 deklaroi si adresë tjetër banimi edhe adresën e apartamentit me qira në Vlorë.

²² Nga aktet në dosje ka rezultuar se kjo pasuri është shitur me kontratën nr. *** rep., nr. ***/** kol., datë **.9.2005, nga shitësit *** dhe Erarbër Madhi, në vlerën 1.600.000 lekë.

²³ Me përjashtim të DV- 2010, ku subjekti ka deklaruar vetëm adresën e banimit në qytetin e Vlorës.

2012). Përveç burimit të ligjshëm, e paprovuar mbetet dhe mënyra e ruajtjes së të ardhurave/kursimeve të pretenduara, nisur nga shuma e konsiderueshme e tyre.

30.2 Pasuria *apartament me sipërfaqe 124,27 m²* e blerë nga znj. ***, duket që nuk është shfrytëzuar asnjëherë prej kësaj të fundit nga momenti i blerjes e deri në ndërrimin e jetës. Subjekti i rivlerësimit është ndarë nga certifikata e gjendjes familjare pikërisht disa ditë pas krijimit të kësaj pasurie, rrethanë që duket se është bërë në përpjekje për të fshehur këtë pasuri dhe për të shmangur verifikimet dhe kontrollet që mund të ushtroheshin ndaj tij për pasurinë.

31. Gjithë sa më sipër, parë në harmoni dhe me deklaratimet kontradiktore të subjektit të rivlerësimit mbi adresat e banimit gjatë periudhës 2005-2016, çojnë në përfundimin se kemi të bëjmë me përpjekje të subjektit të rivlerësimit për të fshehur pasuritë, duke e vendosur këtë të fundit në kushtet e nenit D, pika 5 e aneksit të Kushtetutës, dhe cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, në kuptim të nenit 61, pika 5, të ligjit nr. 84/2016.

V. Kërkimi i ankimit

32. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik në procesin e rivlerësimit, ka të drejtën dhe detyrimin e ushtrimit të kontrollit ndaj vendimeve të dhëna nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, duke vlerësuar nëse vendimmarrja bazohet në një hetim të plotë dhe të gjithanshëm, dhe çmim të drejtë të provave të administruara;

33. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa ka disponuar Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë;

34. Mbështetur në parashikimin e nenit F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, kërkujmë që shkaqet e parashtruara në këtë ankim të merren në konsideratë nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe, pas vlerësimit tërësor të procedurave, për subjektin e rivlerësimit, z. Erarbër Madhi, në përfundim të gjykimit të çështjes, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 621, datë 13.2.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Erarbër Madhi.

KOMISIONERI PUBLIK

Irena NINO

I bashkëlidhet këtij ankimi:

- Rekomandimi për ushtrim ankimi i një komisioni prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të ONM-së, nr. 145/1 prot., datë 9.3.2023.



International Monitoring Operation
*Project for the Support to the Process of Temporary
Re-evaluation of Judges and Prosecutors in Albania*

Prot. No. 145/1

Tirana, 09/03 / 2023

To the
Public Commissioners
Bulevardi "Deshmoret e Kombit", Nr. 6
Tirana



Case Number **ADC/TIR/1/10**
Assessee **Erarbër MADHI**

RECOMMENDATION TO FILE AN APPEAL

according to the Constitution of the Republic of Albania, Annex 'Transitional Qualification Assessment', Article B, paragraph 3, letter c

Introduction

The Assessee Erarbër Madhi holds the office of Judge in the Administrative District Court of Tirana. He is assessed *ex officio* pursuant to Article 179/b, paragraph 3 of the Constitution of the Republic of Albania.

The Re-evaluation process was carried out by the Independent Qualification Commission ("IQC") based on three criteria: assets, background and proficiency. Upon administering the reports of the auxiliary bodies, thorough investigation of the case, administering evidence obtained through the investigation process and submitted by the Assessee, the IQC's Adjudication Panel closed the investigation and notified the Assessee its findings, shifting the burden of proof on a set of issues and requesting for explanations.

The hearing took place on 10 February 2023 and following the deliberation as per Article 55, paragraph 5, Vetting Law, the Adjudication Panel decided to confirm the Assessee in duty pursuant to Article 59 Vetting Law, and the decision was announced publicly on 13 February 2023.

The undersigned International Observers, having reviewed the case file and the results of the public hearing, deem that the evidence administered during the investigation justifies a review of the case by the Appeal Chamber.

Grounds for the recommendation

1. The criticalities in the case of assessee Erarbër Madhi revolve around the assets which he inherited on **05.2019 from his mother *** **

Namely:

- a) the apartment of 124.7 sqm located in Tirana, *** ** Street, admin. unit no.**, building no.**, entrance ** *** ** had bought this asset on ** 04.2012 for the price of 16,776,450 ALL;
- b) a bank account of 4,490,000 ALL resulting from the maturity of treasury bonds which *** ** had acquired on 5.1.2009 at the value of 4.000.000 ALL.

The compound value of these two assets amounts thus to ALL 20.776.450 at the moment of purchase.

The Independent Qualification Commission at the end of the investigation reached the preliminary conclusion that these assets could not have originated from income of the assessee's late parents *** ** and . *** ** (as he claimed), but rather from his own undeclared sources.

Thus, the IQC notified to the assessee that under article 52 Law 84/2016 and article D, para 5, of the Constitution Annex he had the burden to prove the origins of these assets.

2. The International Observers deem that the case file contains objective and consistent evidence, of circumstantial nature, that it was the assessee to provide the source of creation of the assets and that he was unable to dispel the burden of proof resting on him.

In fact:

- The two assets in question are of significant value.
- The assessee is the only son of *** *** and *** ***. The former passed away in the year 2005 and the latter passed away in the year 2019.
- The treasury bonds and the apartment had been acquired by *** *** , respectively, in 2009 and 2012.
- The assessee is the sole legal heir of his mother.
During her lifespan their mutual ties were always maintained, and the assessee eventually inherited the assets in the year 2019.
- *** *** could not possibly have generated sufficient income to purchase the assets. Her salary as teacher and her pension were negligible in comparison to their value. It must be noted that the assessee, on the occasion of the first, second and third questionnaire, refused to respond to the IQC's queries related to the mother's sources of income, alleging that she could not be considered as a person related to him pursuant to Law 84/2016.
Eventually, on the occasion of the fourth questionnaire, the assessee stated that the money used by the mother to purchase the assets had been inherited by her from her husband *** *** in 2005.
- *** *** could not have earned income in the amounts and modalities alleged by the assessee.

In fact:

- o *** *** 's income from the Ministry of Defence (net 1,898,399 ALL for the whole period 1997 to 2005 in the capacity of Colonel, retired in 2002) was barely sufficient to cover the family's living expenses.
- o The International Observers accept that *** *** , technical expert in the field of chemistry, participated in several international conferences and working groups on behalf of the Albanian State. However, the assessee's allegation that his late father could have earned and saved astronomic *extra* income for such kind of activities (totaling up to 511.000 US\$ + 2.640.000 ALL in a timespan of around 10 years) appears *per se* preposterous, in light of the sheer amount claimed
Some further details confirm the criticality of the assessee's allegation:
 - The assessee claims that his father for nine years (1996-2005) earned at the same time two (and even three, between 1998 and 2000) *stable* monthly salaries, each one of a significant amount¹, on top of his normal salary as army Colonel. This fourfold regular work commitment (and salary) appears extravagant.
 - The Ministry of Defence of Albania, in charge of ordering missions and deployments of Army officials, did not confirm either the assessee's

¹ In particular, the assessee claims that for nine years, from 1996 to 2005, his father earned 2000 US\$ per month from the NATO ETWG Group (totaling 216.000 US\$) and in the same period additional 1.500 US\$ per months from the Organization for Prevention of Chemical weapons (totaling 148.000 US\$), plus (between 1998 and 2000) an additional salary of 2000 US\$ per month from NATO's working group on low radiation level in military operations.

allegations about several stable long-duration work relationships with third organizations, or the existence of any monetary compensation².

- The MoD did confirm that it did not pay any additional compensation to the assessee in conjunction with expert missions abroad.
 - The assessee claims that 35.000 US\$ were earned additionally by his father in the form of per diems. Even though the number of his missions abroad remained unclear, it is a fact that the related per diems cannot be considered as savings (considering their function of coverage of daily costs). The jurisprudence of the Appeal Chamber in this sense is clear.
 - There has never been any bank trail of these alleged extra incomes. The sums did not even emerge on the occasion of ***'s succession, when allegedly they were left to ***.
 - The assessee, during the public hearing, claimed that no taxes were paid on these additional incomes, because they were tax-exempt due to their source. The IOs disagree with this argument³, which appears rather an ex-post justification. They deem that the absence of even a minimum tax payment is a further hint against the existence of the income.
 - The assessee specifically pointed at his father's alleged income from international organizations as the source for the creation of the mother's assets. Further (significant) sources of income of the father were neither stated by the assessee nor found through investigation.
- The documents of the case file reliably show that *** and the assessee lived at the same address in Rruga ***, even after the assessee formally departed from the mother's family certificate in **4.2012⁴. It is therefore surprising - and

² The Ministry of Defence (see communication prot. ***/**f* October 2022) provided the IQC merely with two orders, whereby *** was commanded to collaborate with the Stability Pact for Southeastern Europe in 2000 and to participate in study activities abroad in 1998.

Significantly, upon request of the IQC, the NATO representative of Albania clarified that "*the Military Mission of the Republic of Albania to NATO possesses no data that ... *** has been employed by the Military Mission of the Republic of Albania to NATO or the International Military Staff as a representative of Albania at NATO structures.*

*During 1995 – 2002, as an active member of armed forces, Colonel *** might have represented and followed the Working Group for Low Level Radiation in NATO Military Operations. In all instances that he has participated in these meetings, his financial benefits were paid based on the order of the Minister of Defence for sending the employee on service abroad.*" The financial benefits paid by the Ministry of Defence have been considered by the IQC in its analysis.

³ The IOs concur that expert fees paid by international organizations (including NATO) to technical experts are not by default tax-exempt in the Country which is seconding, deploying or sending the expert. International agreements normally grant tax exemption, but only with regard to the hosting country, with no prejudice for tax obligations of experts towards the respective sending countries. Furthermore, *** was not part of NATO personnel (and Albania was not even part of NATO at that time).

⁴ This conclusion is based:

- On the official statements filed by *** with her banks (in 2009 with the Bank of Albania, when she bought the treasury bonds; in 2014 with ***; in 2015 with *** Bank);
- On the official declaration of residence made by *** to the Court of Tirana on the occasion of a lawsuit.
During this trial in 2006 she (in the capacity of plaintiff) had declared as her address the same declared by the assessee in his periodic HIDAACI declarations. It is significant that in this lawsuit *** asked to be allowed to live in the apartment inherited by her and her brother from their father. Thus, it is difficult

suspicious – that during the vetting investigation, the assessee tried to radically contradict this previously undisputed state of play, by affirming:

- that he and his mother (since 2005) always lived in separate addresses. In the standard questionnaire, the assessee stated that he had been living alone “since 2004”.
- that throughout his career he had “never stayed or used (his) parents’ home. Since the moment of separation in 2004 onwards, (he had) always lived in a rented property at the address that (he had) duly declared to HIDAACI. Throughout the period of (his) career as a judge, (he had) never stayed or used the properties of (his) late parents”⁵.
- that his relationship with his mother had become cold and distant and therefore he was completely unaware of the financial and real estate investments she had been undertaking⁶.
- That when he worked as a judge in Vlora between 2005 and 2013 he rented there an apartment for the sum of 10.000 ALL per month (contrary to what he stated to HIDAACI inspectors in 2014)⁷.

This radical change of version by the assessee is questionable, because it runs against several previously given official statements (including the one given to the HIDAACI inspector, as such protected by the sanctions set forth by article 38 of law 9049/2003 on ILDPKI⁸).

The new version is also logically inconsistent, because on the one side the assessee maintains that the assessee’s relationship with his mother had become cold and distant, but - on the other side – he affirms that his mother unilaterally (and apparently without consulting the assessee) took the initiative to provide the assessee’s address to banks and the Court because “she felt certain that (over there) she would receive (the communications)”.

The IOs note that such bizarre change of version can find reasonable explanation by arguing that after his mother had purchased assets which she could not afford, the assessee concocted to artificially distance himself from her. Not by chance, the official separation

to accept the assessee’s claim that his mother had lived in this apartment, at least until 2007 (when the first instance decision was issued) or in 2009 (when the decision became final).

- On the statement made by the assessee himself on * August 2014 to HIDAACI inspector Albana Cami⁴. It is interesting to note that on this occasion the assessee declared that this apartment was being rented by the mother and the expenses were paid by her. He also added that when he was a judge in Fier and Vlora, he mostly “came back every night in Tirana” and sometimes (in Vlora) he stayed at friends without compensation.

The above-mentioned statements and documents (both from the assessee and from her mother) are fully consistent and detailed about their common place of living.

⁵ See the hearing minutes.

⁶ *Ibid.*

⁷ When asked by the HIDAACI inspector, the assessee stated as follows: “During the period I served as judge in Fier and Vlora, I used to go and return every day, and in some cases I lived at my acquaintances without rent”.

⁸HIDAACI inspector *** ***, upon interrogating Erarber Madhi on * August 2014, warned him that any false declarations would make him liable under Article 38 of Law 9049 dated 10.04.2003

of the assessee from the mother's family certificate took place on ** 4.2012, only 4 days after the mother's purchase of the 124,7 sqm apartment.

Conclusions

The International Observers concur that the above factual circumstances, read in conjunction, find reasonable explanation in admitting that the treasury bonds and the apartment of 124,7 sqm located in Tirana, *** ** Street, purchased by ' *** ** respectively in 2009 and 2012, were, in reality, hidden assets of the assessee.

His contrary allegations do not enjoy the same level of rational credibility and are not proven. The issues (both in terms of declaratory shortcomings and in terms of financial analysis), and their potential consequences for the assessee, are of such relevance that they warrant a review by the Appeal Chamber.

In light of the foregoing, the undersigned International Observers

RECOMMEND

that the Public Commissioners appeal the decision of the Independent Qualification Commission of 13 February 2023 confirming Erarbër Machi in duty.

International Observer



~~International Observer~~

~~International Observer~~